Shkollat Publike Worcester – Rrugët e Inovacionit

https://worcesterschools.org/academics/career-pathways/innovation-pathways-program/

Worcester Technical High School, 1 Skyline Drive, Worcester, MA 01605

Drew Weymouth
Drejtor i Rrugëve të Inovacionit
(508) 799-1985
IPPWorcester@worcesterschools.net

Kelsey Lamoureux
Specialiste e Karrierës dhe Partneritetit
(508) 799-1940 Ext. 50499
IPPWorcester@worcesterschools.net

<<Parent Full Name
<<Student Full Name
<<Mailing Address
<<City, State, Zip

27 Dhjetor, 2021

Të Dashur Prindër dhe Kujdestarë,

Gjatë gjithë Janarit 2022, nxënësit e klasës së 9-të do të kenë mundësinë të mësojnë rreth Programit të Rrugëve të Inovacionit të Shkollave Publike Worcester. **Ju lutemi, kini vëmendjen për emaile dhe telefonata në lidhje me seancat e informacionit për të prezantuar më tej Rrugët e Inovacionit si dhe për një Ambjent të Hapur (Open House) të Mërkurë, 2 Shkurt 2022 për të ndihmuar nxënësit të vendosin se në cilat programe ata dëshirojnë të aplikojnë.** Ju lutem vizitoni gjithashtu: https://worcesterschools.org/academics/career-pathways/innovation-pathways-program/.

Ambjenti i Hapur (Open Hose) do të jetë të Mërkurë, 2 Shkurt 2022, nga ora 6:00 p.m. deri në orën 8:00 p.m. në Shkollën Worcester Technical 1 Skyline Dr., Worcester, MA 01605.

Programi i Rrugëve të Inovacionit u hartua për të ndihmuar në zgjerimin e eksplorimit të karrierës përmes arsimit teknik brenda Shkollave Publike Worcester. Nxënësit pjesëmarrës në program do të kenë një vështrim të detajuar të një fushe karriere të interesit të tyre, do të fitojnë kredenciale të njohura nga industria në atë fushë, do të angazhohen në aktivitete kolegji dhe të planifikimit të karrierës, do të marrin klasa të nivelit të kolegjit si përgatitje për avancimin në karrierë dhe do të zgjerojnë përvojën e tyre përmes praktikave ose një projekti të plotë përmbledhës. Shkollat Publike Worcester kanë punuar me shumë organizata dhe biznese lokale për të krijuar një program që plotëson nevojat dhe interesat e nxënësve, si dhe kërkesat e ardhshme të tregut të punës.

Programi i Rrugëve të Inovacionit është i hapur për nxënësit aktualë të klasave të 9-ta dhe të 10-ta (preferenca u jepet nxënësve të klasës së 9-të) që ndjekin shkollat Burncoat, Claremont, Doherty, North, South dhe University Park.

Nxënësit e interesuar për karrierë në një nga sektorët e mëposhtëm duhet të konsiderojnë aplikimin në Programin e Rrugëve të Inovacionit:

Industri Përpunuese e Avancuar – Modele kompjuterike, / krijim/ zhvillim produkti, printim 3-D, përdorim makinerish
Bioteknologji – Këkime biologjike, aftësi laboratorike, krijim dhe prodhim i barnave/ ilaçeve
Biznes dhe Marketing – Planifikim biznesi dhe aftësi financiare, sipërmarrje, marketing për audiencat e targetuara
Shkenca Kompjuterike – Krijim faqesh internet, aftësi programimi, siguri kibernetike

Shkollat Publike Worcester janë një Mundësi e Barabartë/ Punëdhënes me Veprim Afirmativ/ Institucion Edukimi që nuk diskriminon pavarësish racës, ngjyrës, prejardhjes, seksit, gjinisë, moshës, besimit fetar, origjinës kombëtare, identitetit ose shprehjes gjinor, gjendjes civile, orientimit seksual, paaftesisë, shtatzënisë ose një gjendjeje që ka lidhje me të, statusit të veteranit apo vendstrehimit. Shkollat Publike Worcester sigurojnë akses punësimi të barabartë dhe një sërë programesh edukimi të përgjithshem dhe profesional. Për më tepër informacion në lidhje me këtë Mundësi të Barabartë /Veprim Afirmativ, kontaktoni Manaxheri(e)n e Burimeve Njerezore në, 20 Irving Street, Worcester, MA 01609, 508-799-3020.

Ndëtim dhe Inxhinjeritë Përkatëse – Dokumentat e ndërtimit, studim dhe vizitë për projektimin dhe ndërtimin e ndëtesave komerciale, zdrukthëtari dhe aftësi të tjera ndërtimi

Kujdes Shëndetëor – Kujdes bazë për pacientin, terminologji mjekësore, anatomi dhe fiziologji, këkim në një shumëllojshmëri karrierash mjekësore, trajnim për tu bërë asistent infermieri i çertifikuar (C.N.A.)
Teknologji Informacioni – Sistemet operative, pajisjet e kompjuterit, rrjeti (networking, siguria kibernetike

Detajet e Programit të Rrugëve të Inovacionit:
Të gjithë komponentët e këtij programi janë pjesë e krediteve të rregullta akademike të nxënësve pasi ata punojnë drejt diplomimit dhe do të jenë në transkriptet e tyre

- Dy vite mësim në sektorin e zgjedhur të karrierës në Shkollën e Mesme Teknike Worcester
    - 1:30 p.m.-5:15 p.m. dy ditë në javë (zakonisht nga Nëntori deri në Mars)
    - Nxënësit mbarojnë dhe largohen nga shkolla në orën 1:00 p.m dhe transportohen me autobus shkolle nga shkolla e tyre e mesme në Worcester Tech në ditët e mësimit për të marrë pjesë në mësim.
    - Klasat mbahen zakonisht të Martave, të Mërkurave dhe të Enjteve por zakonisht mbahen në dy nga këto ditë
- Regjistrimi për në klasat e Karrierës dhe Planifikimit Akademik në shkollën e tyre të mesme (high school)
    - Hartim planesh për arsimin e lartë dhe karrierën e ardhshme, mësim dhe praktikim i aftësive të punësimit, përmirësim i aftësive teknike dhe komunikuese dhe garanci për suksesin e tyre në shkollë dhe në Programin e Rrugëve të Inovacionit
- 100-orë praktikë (zakonisht në verë) ose një projekt përmbledhës përfundimtar në maturë
- Përfundimi i dy klasave të nivelit të kolegjit gjatë shkollës së mesme (high school)

Aplikimet do të jenë të disponueshme duke filluar nga 2 Shkurti, 2022 si në internet ashtu edhe përmes zyrës së udhëzimeve. Kandidatët e kualifikuar po i kalojnë klasat e tyre në këtë periudhë të vitit, kanë frekuentim dhe përkushtim të mirë në shkollë, i kryejnë detyrat në kohë dhe nuk kanë shqetësime serioze lidhur me sigurinë gjatë shkollës së mesme.

Ju lutemi merrni parasysh nëse nxënësi juaj ka kohën dhe interesin për të përfunduar këtë program. Nëse nxënësit aplikojnë dhe pranohen, angazhimi në këtë program zëvendëson të gjitha angazhimet e tjera gjatë orëve të planifikuara. Ky është një shans shumë i mirë për të bashkuar planifikimin akademik dhe të karrierës për nxënësin tuaj. Ju falënderoj për konsideratën tuaj.

Sinqerisht,

__Nënshkruar___

Drew Weymouth
Dreitor i Rrugëve të Inovacionit
Shkollat Publike Worcester
(508)799-1985
IPPWorcester@worcesterschools.net

___Nënshkruar___

Kelsey Lamoureux
Specialiste e Karrierës dhe Partneritetit
Shkollat Publike Worcester
(508) 799-1940 Ext. 50499
IPPWorcester@worcesterschools.net

Shkollat Publike Worcester janë një Mundësi e Barabartë/ Punëdhënes me Veprim Afirmativ/ Institucion Edukimi që nuk diskriminon pavarësish racës, ngjyrës, prejardhjes, seksit, gjinisë, moshës, besimit fetar, origjinës kombëtare, identitetit ose shprehjes gjinor, gjendjes civile, orientimit seksual, paaftesisë, shtatzënisë ose një gjendjeje që ka lidhje me të, statusit të veteranit apo vendstrehimit. Shkollat Publike Worcester sigurojnë akses punësimi të barabartë dhe një sërë programesh edukimi të përgjithshem dhe profesional. Për më tepër informacion në lidhje me këtë Mundësi të Barabartë /Veprim Afirmativ, kontaktoni Manaxheri(e)n e Burimeve Njerezore në, 20 Irving Street, Worcester, MA 01609, 508-799-3020.